

Programi për kujtesën kolektive dhe drejtësinë tranzicionale
Raport i gjetjeve nga grupet e fokusit

Prishtinë – Kosovë
2010

Raport i gjetjeve nga fokus grupet¹

Alter Habitus ka filluar programin e Kujtesës Kolektive dhe Drejtësisë Tranzicionale në Kosovë (më tutje: KK dhe DT), me anë të të cilit synon t'i dokumentojë dhe hulumtojë memorialet e ndërtuara në Kosovë në periudhën 1999-2009. Alter Habitus konsideron se është me rëndësi të trajtohen fillimisht konturat themelore se si kuptohen dhe organizohen kujtesa kolektive dhe drejtësia tranzicionale. Në shkurt të vitit 2010, Alter Habitus ka realizuar fokus grupe në shtatë komuna të Kosovës: Gjakovë, Prizren, Ferizaj, Pejë, Gjiilan, Kaçanik, Han të Elezit dhe Prishtinë. Temat kryesore në to përfshinin pyetjet:

- Si kuptohet KK dhe DT?
- Si janë të organizuara memorialet në komunën e juaj?
- A janë ngritur memoriale për gratë dëshmore ose gratë që kanë kontribuar për çështjen kombëtare?
- Cilat janë nismat ekzistuese për drejtësinë tranzicionale në komunën e juaj?

Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në fokus grupe ishte 123, me profilet e mëposhtme profesionale:

- Drejtorë të Departamenteve Komunale për Planifikim Urban
- Drejtorë të Departamenteve Komunale për Rini, Kulturë dhe Sport
- OJQ-të aktive në komunë
- Shoqata e Veteranëve të Luftës
- Shoqata e ish të Burgosurve Politikë, ish të burgosur politikë
- Aktivistë për të drejtat e njeriut
- OJQ që merren me trashëgimi kulturore
- OJQ që merren me çështje gjinore ose me çështje të grave
- Përfaqësues të partive politike
- Përfaqësues të fshatrave të komunës
- Qytetarë

¹ Meqë Alter Habitus ka bërë disa ndryshime në faqen e internetit, ky raport u ristrukturua në tetor 2017 dhe u shndërrua në PDF për përdorimin dhe referencimin e duhur prej lexuesit. Edhe pse raporti është i vitit 2010, në vitet pasuese Alter Habitus ka vazhduar me projekte të tjera për kujtesën kolektive në bashkëpunim me Programin ZDF-Kosovë. Informacioni lidhur me bashkëpunimin tonë mund të gjendet në faqen tonë të internetit ose në faqen e Facebook të forum ZFD - Programi i Kosovës.

Kujtesa kolektive

Terminologjia

Ka përdorime të ndryshme të termave për lloje të ndryshme ose të njëjta memorialesh. Për shembull: *lapidar, përmendore, bust* dhe *shtatore* përdoren gjerësisht për skulpturat. Alter Habitus vendosi që nën emërtimin 'memorial' në këtë raport të nënkuptojë të gjitha llojet e skulpturave ose të varrezave që kanë pllaka të caktuara me emrat e gdhendur të dëshmorëve. Në mbishkrimet e pllakave përkujtimore gjetëm terme të ndryshme për shembull: *martir, hero* ose *dëshmor*.

Manifestimi i kujtesës kolektive

Kujtesa kolektive kryesisht manifestohet në monumente dhe vende përkujtimore si varreza, akademi përkujtimore, emërtime rrugësh, përmes festave kombëtare ku përkujtohet jeta e disa heronjve kombëtarë, si dhe përmes këngëve.

Kujtesën kolektive unë e kuptoj si shpëtim të mbamendjes së popullit për historinë e vet – Kaçanik, Hani i Elezit.

Aspekti ligjor – kujtesa institucionale ose e painstitucionalizuar

Rezultati i përbashkët i pothuajse të gjitha grupeve të fokusit është kërkesa për të pasur një formë të institucionalizuar të trajtimit të së kaluarës, duke përfshirë aspekte të kujtesës kolektive të manifestuara përmes përmendoreve. Është përmendur shpesh se ka nevojë të caktohet një kornizë ligjore nëpërmjet të cilës do të ketë standarde dhe norma për ndërtimin e memorialeve.²

Procedurat dhe praktikat për ndërtimin e memorialeve

Departamentet brenda komunave nuk kanë informacion të saktë lidhur me numrin e memorialeve të ndërtuara nga viti 1999-2009, procedurat dhe as mbështetjen financiare. Na është thënë se arsyeja kryesore është te fakti që pas luftës së vitit 1999 ende nuk ishin themeluar departamentet komunale që të merreshin posaçërisht me çështjet e memorialeve.

² Kuvendi i Kosovës miratoi një ligj në shtator të vitit 2005 që shpall memorialin e Adem Jasharit në Prekaz si një monument me interes të veçantë kombëtar dhe rëndësi 'ontologjike, antropologjike, historike dhe kulturore' për qytetarët e Kosovës. Sipas nenit 1, ky ligj synon të mbrojë memorialin nga „ndikimet politike dhe detyrimet e institucioneve të Kosovës“. Neni 7 thotë se "Qeveria e Kosovës do të sigurojë mjete financiare për ngritjen e memorialit", ndërsa Neni 8 thekson se "është e ndaluar të ketë ndonjë akt të partive politike, si tubime ose manifestime të tjera partiake" brenda kësaj hapësire. Ligji gjendet në http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2004_39_al.pdf

Prandaj edhe nuk është gjithmonë krejt e qartë se cilat janë procedurat për të ndërtuar një memorial dhe nëse janë të njëjtat në secilën komunë.

Drejtoria Komunale për Urbanizëm dhe Planifikim në secilën komunë konsiderohet si departamenti që përcakton vendndodhjen e memorialeve dhe lëshon lejen për çdo lloj ndërtimi, që përfshin edhe ndërtimin e memorialeve. Kjo rregull nuk i përfshinte fshatrat. Monumentet janë ndërtuar kryesisht në vendin ku kanë rënë dëshmorët dhe në shumicën e këtyre rasteve, nuk ka pasur kërkesa për leje ndërtimi drejtuar departamenteve komunale. Është marrë si i mirëqenë fakti se komunat do të pajtoheshin për përkujtimin e dëshmorëve, prandaj nevoja për ta formalizuar këtë përmes procedurave komunale nuk është parë e nevojshme. Në shumicën e rasteve, nismat për ndërtimin e ndonjë memoriali kanë ardhur kryesisht nga familjet e dëshmorëve, Shoqata e Veteranëve të Luftës (ShVL), e në disa raste edhe nga Asambleja Komunale.

Disa nga memoriale që ndodhen në qytete, janë të ndërtuara nëpërmjet procedurave ose përkrahjes komunale dhe si projekteve të komunës. Për shembull, në **Gjakovë**, varrezat e Çabratit janë ndërtuar me kërkesën e dy a tri familjeve të dëshmorëve, ndërkohë që financimi është bërë nga komuna. Familja Gola (familje dëshmorësh) ka ndërtuar memorialin e dëshmoreve në tokën e vet.

Në **Prizren**, procedurat formale janë përfillur vetëm në qytet, ndërsa në fshatra janë kryesisht familjarët ose ShVL që kanë ndërmarrë nismat për t'i ndërtuar memorialet. Në **Ferizaj**, ShVL kryesisht ndërmjetëson dhe administron nismat për ndërtimin e memorialeve. Procedurat ndjekin këta hapa: ShVL në emër të inicuesve për projektin e memorialit e paraqet kërkesën për zgjedhjen e lokacionit të komuna. Pastaj shpallet konkursi për dizajnimin e projektit. Konkursi shpallet nga pala financuese, që mund të jetë komuna, ndonjë kompani private, ose në disa raste familja e dëshmorit. Në të gjitha rastet, financuesi vendos kush e fiton konkursin.

Në **Pejë**, si në shumicën e komunave tjera, Departamenti i Urbanizmit lëshon leje dhe bën projekte për ndërtimin e memorialeve. Në **Gjilan**, procesi i ndërtimit të memorialeve nuk dallon shumë nga komunat e lartpërmendura. Edhe këtu, ShVL shpesh ndërmjetëson mes nismëtarëve të një memoriali dhe komunës. Në këtë komunë, sikurse në **Prizren**, procesi i memorializimit shpesh mbetet peng mes fraksioneve të ndryshme politike.

Në **Mitrovicë** (megjithëse nuk u zhvillua asnjë fokus grup), një qytetar që na tregoi rrugën të një monument, u ankua se si po merren vendimet për ndërtimin e monumenteve/memorialeve. Ai na tregoi për një dëshmor që kishte kontribuar për çlirimin kombëtar që nga periudha e socializmit jugosllav dhe ishte vrarë duke luftuar gjatë luftës së vitit 1998/'99. Sipas tij, mbasi familja e tij është e varfër, nuk kishte njeri që t'ia iniciante ndërtimin e një memoriali.

Në anën tjetër, familjet ekonomikisht më të fuqishme dhe ata që kanë rrjet të mirë shoqëror, marrin nisma për ndërtim memoriali për një dëshmor që ishte familjar ose pjesë e këtij rrjeti social e politik. Pjesë të kësaj teme u diskutuan edhe në fokus grupe, ku u ngrit pyetja: kush meriton t'i ndërtohet memoriali?

'Monumentet janë ndërtuar shumë shpejt e pa kritere të forta, me imponime, nuk i janë përshtatë arkitekturës, pa konkurse...' – Gjakovë

Mbrojtja e memorialeve

Nga fokus grupet nuk pat informata se kë e konsiderojnë pjesmarrësit si përgjegjës për mbrojtjen e memorialeve. Në të gjitha komunat ku u zhvilluan grupet e fokusit, kuptuam se memorialet e ndërtuara në periudhën 1999-2009 nuk po mbrohen nga Enti për Mbrojtjen e Monumenteve apo nga ndonjë organizatë qeveritare a joqeveritare.

Aspekti gjinor

Në përgjithësi, memorialet janë ndërtuar për të nderuar kryesisht heronj dhe jo heroina. Megjithatë, ka njëfarë përpjekjeje minimale për ta njohur dhe përkujtuar edhe kontributin e grave që luftuan në mënyra të ndryshme për çlirimin kombëtar.

Në **Kaçanik**, Qendra për Shëndetësi dhe Përkujdesje Familjare mban emrin e dy grave (motra) që vdiqën gjatë luftës së vitit 1998/'99. Në fokus grup nuk u përmend nëse ato kishin qenë luftëtare të UÇK-së. Mësuam se kishte pasur një takim që ish-pjesëtarët e UÇK-së e kishin mbajtur në Drenas, por nuk morëm asnjë informatë për ndonjë takim pasues ose nëse ky takim ishte bërë për socializim apo për bashkëpunim profesional.

Në fshatin Kosoriq të **Pejës**, me kontribut familjar u ndërtua një memorial për të nderuar dy gra (nënë e bijë) të vrara gjatë luftës. Pjesëmarrësit e dinin se njëra kishte qenë aktiviste e çlirimit kombëtar para luftës së fundit në Kosovë. Në oborrin e spitalit kryesor të Pejës komuna ka përkujtuar luftëtaren e UÇK-së Myrvete Maksuti, duke gdhendur emrin e saj në një pllakë përkujtimore. Pjesëmarrësit thanë se Myrvete Maksuti ishte vrarë gjatë përballjes me forcat ushtarake serbe në oborrin e spitalit. Përgjithësisht në Pejë, nëpër memorialet kolektive si varrezat, janë të gdhendur emrat e të gjithë dëshmorëve, burra dhe gra.

Në **Gjilan**, në fshatin Zhegovc, është ngritur një memorial për aktivisten e çështjes kombëtare, Hanumshahe Dumani.

Aspekti estetik

Në **Ferizaj** kishte pikëpamje të ndryshme lidhur me atë se si duken monumentet. Disa pjesëmarrës mbështesnin idenë se dëshmori i portretizuar në skulpturë duhet të ketë armë në dorë, sepse memoriali duhet të përcjellë mesazhin se ka vdekur duke luftuar për liri. Pikëpamja kryesore ishte se aspekti i dizajnit të memorialeve duhet lënë artistëve.

‘Nëse nderohet një dëshkmor nuk don me thane me ia qitë edhe kallashin aty, se është pak e vrazhdë...për mu heroi nuk është kallashi, është liria. Don me thane asht më mire me e paraqitë me një simbol të paqes, sesa me një simbol të vrazhdë të luftës’ – Ferizaj

Pjesëmarrësit besojnë fuqimisht se ky proces duhet të ketë standarde dhe norma me anë të të cilave mund të përçohet kujtesa kolektive për dëshmorët dhe për luftën. Ndër sugjerimet e tjera që dolën në diskutim ishte ideja për të krijuar një muze.

Sipas pjesëmarrësve, ka materiale tashmë të mbledhura që mund të ekspozohen, si rrobat e ushtarëve, librat e tyre dhe sendet e tjera personale.

‘Ai që e ka pushtu kujtesën, e ka pushtu edhe individin, e ka pushtu edhe vendin, edhe territorin, edhe hapsirën’ - Prizren

Në komunën e **Kaçanikut dhe Hanit të Elezit**, siç pritej, diskutimi u drejtua nga marsi 1999 kur ushtria serbe, policia dhe grupet paraushtarake deportuan popullsinë shqiptare nga Kosova. Për sa i përket përkujtimit, pjesëmarrësit konfirmuan se më 2008 qeveria e Kosovës ka vënë një pllakë përkujtimore në tokën midis Kosovës dhe Maqedonisë, që është zona kur më 1999 popullsia e deportuar shqiptare po priste ta kalonte kufirin për në Maqedoni. Pjesëmarrësit konsiderojnë se kjo pllakë është simbolike meqë përfaqëson deportimin e shqiptarëve nga Kosova. Kaçaniku dhe Hani i Elezit, të ndarë së voni si dy komuna, janë shembuj të mirë të bashkëpunimit ndërmjet të gjitha organizatave si departamentet komunale, komuniteti i biznesit, si dhe Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK), për krijimin dhe ndërtimin e hapësirës së përbashkët ku janë rivarrosur të gjithë dëshmorët e të dyja komunave.

Vendndodhja e memorialeve

Një çështje që i shqetësonte pjesëmarrësit në grupin e fokusit në Pejë, ishte vënia e busteve ose e pllakave përkujtimore në hapësira që janë pronë publike. Pjesëmarrësit thanë se kjo, krahas me zhvillimin e qytetit, p.sh. ndërtimin e autostradave, do të krijonte konflikte, sepse disa nga këto memoriale ishin ngritur skaj rrugëve. Në raste të tilla, duhet të zhvendosen në vende të tjera, ose të gjenden zgjidhje të tjera.

Drejtësia tranzicionale

Sa i përket drejtësisë tranzicionale, të gjitha komunat në të cilat u zhvilluan fokus grupet i karakterizon paqartësia e vetë termit *drejtësi tranzicionale (DT)*. Kur diskutojmë idenë e ballafaqimit me të kaluarën, vullneti shprehet vetëm nëse nënkupton që nismat konkrete të vijnë nga qeveria e Kosovës. Pjesëmarrësit nuk e shohin përballjen me të kaluarën si proces të pajtimit ndëretnik, por si nevojë emergjente për t’i regjistruar dhe finalizuar të dhënat mbi numrin e njerëzve të vrarë, të deportuar dhe të përdhunuar gjatë luftës; regjistrimin e të gjitha dëmeve materiale të kësaj periudhe; përgatitjen e aktakuzës ndaj Serbisë, si dhe kërkesën për kompensim të dëmeve të luftës.

Pjesëmarrësit theksuan sidomos mungesën e trajtimit të duhur të ish-të burgosurve politikë dhe të tjerëve që janë të dëmtuar nga lufta. Familjet e viktimave dhe të personave të zhdukur vazhdojnë të marginalizohen sepse, përveçse janë peng i të kaluarës së dhimbshme, vuajnë edhe nga jetesa në kushte të vështira ekonomike. Ligji për *Statusin dhe*

të Drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Veteranëve, Invalidëve, Pjesëtarëve të UÇK-së dhe Familjeve të Viktimave Civile është nënshkruar në maj të vitit 2005 nga kreu i UNMIK-ut, Soren Jessen Petersen, në praninë e kryeministrit të Kosovës Agim Çeku dhe përfaqësuesve të organizatave të ndryshme. "Me këtë ligj pranojmë kontributin që martirët e luftës kanë dhënë për paqen në Kosovë" - Kryeministri Çeku në atë rast pati deklaruar se megjithëse ligji duhet të ishte miratuar shumë më parë, është megjithatë e rëndësishme që nga tani këto kategori do të ketë mbrojtjen institucionale.

Në realitet, thotë Qendra për Hulumtime, Dokumentim dhe Publikim (QHDP), kjo 'mbrojtje institucionale' është shumë simbolike dhe ka disa parapëlqime për familje të caktuara sa i përket shpërndarjes së beneficioneve.

'Për fat të keq, familjet e viktimave çdo ditë e ma shumë po mbesin të vetmume, pakkush po u kushton kujdes...janë përvjetorët, kur shkojnë gazetarët i intervistojnë, ndonjë politikan shkon e mban ndonjë fjalim, edhe aty mbyllet krejt çështja e tyre, d.m.th. 364 ditë tjera ata janë të vetmum' – QHDP, Prishtinë

Në disa raste, si në Kaçanik dhe Han të Elezit, pjesëmarrësit tregonin me emra kriminelët që i kishin vrarë të burgosurit e burgut të Dubravës. Njëri pjesëmarrës tregoi edhe për dëshminë e një ushtari të UÇK-së që thoshte se nëpër shtëpi të këtyre fshatrave kanë gjetur rroba të grisura të grave, duke aluduar në keqtrajtimin dhe përdhunimin e tyre. Më pastaj, thotë ai, këto rroba i kanë tubuar ushtarët e UÇK-së dhe i kanë groposur.

"A di çka," m' thotë ai ushtari, "ato tesha i kemi marrë dhe i kemi futë në grope" Kurrë nuk i harroj ato fjalë' – Kaçanik, Hani i Elezit.

Ndër temat e tjera të rëndësishme është ngritur kërkesa që Kosova të ketë organizata në nivel shtetëror që merren me drejtësinë tranzicionale. U tha se iniciativat që vijnë nga OJQ-të, meqë varen nga donatorët, nuk janë të qëndrueshme.

Në Gjakovë dhe Gjilan, sipas pjesëmarrësve të fokus grupeve, menjëherë pas luftës kishte pasur përpjekje për regjistrimin e dëmeve të luftës. Në Gjakovë, midis viteve 1999 dhe 2000 janë vizituar 67 fshatra ku janë regjistruar objektet e djegura si dhe kushtet sociale të familjeve. Këto të dhëna të mbledhura i janë dhënë Kuvendit të Komunës. Pjesëmarrësit nuk kanë informacion se cili ekip e ka kryer këtë regjistrim. Në Gjilan, sipas një ish-punonjësi komunal të Gjykatës së Qarkut në vitin 2002, qeveria e përkohshme e atëhershme kishte themeluar një grup juristësh që kishte evidentuar viktimat e luftës dhe kishte regjistruar dëmet e luftës. Sipas këtij pjesëmarrësi, ky material prej 150 faqeve iu dha Policisë së UNMIK-ut, e cila pastaj ia përcolli EULEX-it. Nuk ka informacion të mëtejshëm lidhur me këtë material evident të dëshmive të krimeve të luftës dhe të regjistrimit të dëmeve të luftës.

Edhe 11 vjet pas përfundimit të luftës Kosova është me 1845 persona të pagjetur, ndër të cilët janë afër 500 joshqiptarë, me një 'armatë' familjarësh të viktimave dhe të të pagjeturve, të paintegruar në shoqëri, të pakënaqur me reparacionet simbolike financiare që ndahen nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, të pakënaqur me trajtimin nga vetë shoqëria...' – QHDP, Prishtinë.

Një nismë serioze në punën e ballafaqimit me të kaluarën në nivelin rajonal është bërë nga Fondi për të Drejtën Humanitare, i cili është iniciues i krijimit të një komisioni rajonal për nxjerrjen e fakteve për krime lufte, si dhe të fakteve për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Ky komision do ta mbulojë periudhën 1991-2001, kur përfshihen të gjitha luftërat e ish-Jugosllavisë përfshirë edhe konfliktin në Maqedoni më 2001. Në fokus grupe pak pjesëmarrës dinin për këtë nismë dhe ata që kishin njohuri, ishin kryesisht vetë pjesë e kësaj ndërmarrjeje.

Në përgjithësi, në këtë pjesë të diskutimit, nga fokus grupet u vu re një lloj mosbesimi dhe pasigurie mbi kompetencat e organeve qeveritare dhe ndërkombëtare, si dhe mbi rolin e këtyre të fundit në këtë proces.

‘Ndërkombëtarët kanë insistu me falë dhe me harru... Është antagonizëm me atë që ju kërkoni, sepse ju kërkoni të kujtojmë një çështje, e në anën tjetër bëni thirrje të harrohet’ – Prizren

Këto dy tema – kujtesa kolektive dhe drejtësia tranzicionale – pjesë thelbësore e njëra-tjetrës, ishin të vështira për t’u diskutuar në forma të fokus grupeve, qoftë nga aspektet teorike, qoftë nga ato praktike. Megjithatë, ky raport i shkurtër është fokusuar vetëm në gjetjet kryesore nga diskutimet me shpresën se do të japë një pasqyrë të përgjithshme të dinamikës së kujtesës kolektive dhe të drejtësisë tranzicionale, ashtu siç kuptohet ajo në shoqërinë kosovare. Këto gjetje krijojnë një bazë të fortë mbi të cilën mund të detajohen hulumtimet e ardhshme në fushën e kujtesës kolektive.

Përmbyllje

Siç u tha në fillim të këtij raporti, qëllimi i fokus grupeve ishte më shumë që të krijohet një tablo rreth asaj se si njerëzit e kuptojnë kujtesën kolektive dhe drejtësinë tranzicionale; procedurat dhe praktikën për t’i ndërtuar ato, si dhe aspektet e tyre gjinore dhe estetike. Të gjeturat na tregojnë për disa çështje që mund të përgjithësohen, e që janë vënë në këtë seksion kryesisht si hipotezë që duhet rishikuar dhe konfirmuar në fazat e tjera të hulumtimit. Për më tej, ky seksion sjell edhe pyetje të tjera për hulumtim që duhen adresuar dhe kësaj krijon udhëzime se cilët duhet të jenë hapat e mëtejshme për punë dhe bashkëpunim. Gjatë punës në terren, Alter Habitus bisedoi me punonjësit komunalë në departamente të ndryshme lidhur me procedurat dhe praktikën e ndërtimit të monumenteve/memorialeve dhe pyeti për vendndodhjen e tyre në qytete ose në fshatra. Shpesh ndodhte që informacioni i marrë nga një departament komunal ose Shoqata e Veteranëve të Luftës (ShVL) nuk përkonte me situatën reale në teren. Kjo tregon se akoma nuk ekziston një praktikë e qartë dhe e njëjtë në secilën komunë lidhur me mënyrën se si ndërtohen memorialet, ku vendosen ato dhe sa janë në numër. Për këtë arsye, është shprehur nevoja që kjo çështje të rregullohet institucionalisht. Çështja e institucionalizimit u shfaq edhe në diskutimin se kujt i janë ngritur memorialet? Kush meriton më shumë që të ketë memorial? A luajnë rol çështjet ekonomike dhe përkatësia politike në vendimin për të ndërtuar një monument për një dëshmor? Në këtë vij tranzicionale, memorialet veçme të ndërtuara nuk kanë mbrojtje institucionale. Ato të ndërtuara me mjete familjare mbrohen dhe mirëmbahen nga vetë familjet e dëshmorëve.

Sa i përket aspektit gjinor të kujtesës kolektive, e shprehur nëpërmjet monumenteve dhe memorialeve, siç pritet, janë heronjtë burra që përkujtohen. Marrëdhëniet shoqërore ndjekin ato të pushtetit pothuajse në çdo sferë shoqërore, dhe kujtesa kolektive e shprehur përmes monumenteve dhe memorialeve nuk përbën ndonjë përjashtim. Në një shoqëri të dominuar nga burrat, përkujtimi i grave luftëtare të UÇK-së ose të tjerave që kanë kontribuar në mënyra të ndryshme për çlirimin kombëtar, ndjek normat kulturore, të cilat funksionojnë brenda kornizës së dominimit patriarkal dhe pasqyrohen në sferën private dhe atë publike.

Nga pikëpamja estetike, siç është thënë edhe në ngjarjet dhe diskutimet e tjera të Alter Habitus, edhe nga këto grupe fokusi doli se memorialet në Kosovë më së shumti ngjajnë me artin socrealist të pas-Luftës së Dytë Botërore. Dallimi, megjithatë, është se monumentet dhe memorialet e ndërtuara pas luftës së vitit 1999 në Kosovë kanë simbolet kombëtare si flamuri kombëtar, emblema e UÇK-së, ose plisat e bardhë shqiptarë. Artistë nga Shqipëria, prej të cilëve disa ishin të famshëm gjatë regjimit komunist, kanë gdhendur disa nga monumentet që nderojnë luftëtarët e UÇK-së. Zakonisht, skulpturat vihen në pedestal dhe kanë përmasa të mëdha, duke e shfaqur luftëtarin me armë dhe granatë dore. Megjithatë, të rinjtë artikulojnë nevojën për një lloj tjetër përkujtimi që përkon me planifikimin urban dhe përputhet me krijimet e artit bashkëkohor.

Lidhur me drejtësinë tranzicionale diskutimi së pari u bë për ta kuptuar qartë termin, çka na tregoi se organizatat që punojnë në këtë fushë kanë nevojë për shpjegime shitesë dhe mbase praktika të DT nga vendet e tjera (diçka që po bën KOMRA). Pjesëmarrësit konsideruan se procesi i materializimit të kujtesës dhe ai i trajtimit të të kaluarës kërkojnë punë konkrete nga qeveria. Qytetarët në grupe fokusi konsideruan se ky proces ka qenë shënjestër e grupeve të ndryshme politike dhe e çështjeve të parëndësishme.